

UDHËZIM
Nr. 3, datë 27.7.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR APLIKIMIN PËR REGJISTRIMIN E NJË
KIMIKATI INDUSTRIAL**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 9108, datë 17.7.2003, “Për substancat dhe preparatet kimike”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Para hedhjes në treg të kimikatit (substancës/përzjerjes) që do të përdoret për qëllime industriale, prodhuesi dhe/ose impor-tuesi paraqesin në ministri një aplikim me shkrim për regjistrimin e tij, në gjuhën shqipe, sipas formatit në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij udhë-zimi.

2. Çdo kimikat industrial që i nënshtrohet regjistrimit duhet të jetë i regjistruar të paktën në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në Agjencinë Evropiane të Kimikateve;

3. Dosja e aplikimit për regjistrimin e çdo substance/përzjerje përmban:

a) emrin, mbiemrin, vendbanimin dhe numrin e identifikimit të personit fizik, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare;

b) emrin dhe adresën e personit juridik, të prodhuesit të huaj të substancës së importuar, të detyruar për regjistrim;

c) emrin tregtar të kimikatit;

d) të dhënat për sasinë e kimikatit që regjistrohet;

e) të dhëna mbi qëllimin e përdorimit;

f) të dhënat mbi përbërjen e kimikatit;

g) listën e të dhënave të sigurisë teknike së substancës/përzjerjes së rrezikshme, që regjis-trohet.

4. Të dhënat për sigurinë teknike të substancës/përzjerjes së rrezikshme që regjis-trohet, e përmendur në shkronjën “g”, të pikës 3, të këtij udhëzimi, përfshijnë:

a) identifikimi i përzjerjes ose substancës;

b) identifikimi i kompanisë ose ndërmarrjes;

c) identifikimi i rrezikut;

d) përmbajtja/informacion mbi përbërësit;

e) masat e ndihmës së parë;

f) masat kundër zjarrit;

g) masat ndaj shkarkimeve aksidentale;

h) mirëmbajtja dhe ruajtja;

i) kontrollat e ekspozimit/mbrojtja e perso-nelit;

j) vetitë fizike dhe kimike;

k) stabiliteti dhe reaktiviteti;

l) informacion toksikologjik;

m) informacion ekologjik;

n) konsiderata mbi asgjësimin;

o) informacion mbi transportin;

p) informacion tjetër.

5. Zyra përgjegjëse për kimikatet në Ministrinë e Mjedisit, brenda 60 ditëve nga paraqitja e aplikimit kontrollon plotësimin e dosjes së aplikimit dhe nëse plotësohen kushtet për regjistrim, përcakton numrin e regjistrimit për çdo substance ose përzjerje të regjistruar.

6. Zyra përgjegjëse për kimikatet i njofton aplikuesit numrin e regjistrimit dhe lëshon miratimin e regjistrimit për kimikatin në fjalë, sipas formatit të shtojcës 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7. Nëse nuk plotësohen kushtet për regjistrim, Ministria brenda 30 ditëve, e refuzon regjistrimin.

8. Zyra përgjegjëse për kimikatet, vendos në regjistër, emrin e aplikantit (prodhues apo importues), emrin e kimikatit të regjistruar, sasinë dhe qëllimin e përdorimit;

9. Prodhuesi dhe/ose importuesi që ka regjistruar një kimikat, dërgon të dhënat e sasive të kimikateve që vendos në treg dhe ndryshime të tjera të të dhënave të kimikateve të regjistruara, brenda datës 31 mars të vitit në vijim pas regjistrimit.

10. Prodhuesi dhe/ose importuesi, njofton zyrën e kimikateve për çdo ndryshim të të dhënave të tij, sipas pikës 3 të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka

SHTOJCA 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MJEDISIT

FORMULARI I KËRKESËS PËR REGJISTRIM TË KIMIKATIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. ____

Seksioni 1:	Të dhëna mbi prodhuesin/importuesin
Emri i personit fizik/juridik: _____	
Emri tregtar: _____	
Numri i Kodit të Regjistrimit të _____ NIPT: _____	
Adresa e biznesit: _____	
Qyteti: _____	Shteti: _____ Kodi postar: _____
Adresa e emailit: _____	
Telefon: _____	Fax: _____

Seksioni 2:	Të dhëna të pikës së kontaktit
Emri: z/zj _____	
Pozicioni: _____	
Telefon: _____	Fax: _____
Email: _____	

Seksioni 3:	Të dhëna të kimikatit
Emri: _____	
Sasia: _____	
Perberja: _____	
Qellimi i përdorimit: _____	

Emri: _____ Pozicioni: _____

Firma: _____ Data: / /

SHTOJCA 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

AKT I REGJISTRIMIT TË KIMIKATIT

Në zbatim të nenit 10 të ligjit 9108, datë 17.07.2003“ Për substancat dhe preparatet kimike”, Ministri

VENDOSI:

Regjistrimin e substancës/përzjerjes si më poshtë:

1. Numri i regjistrimit të kimikatit:
2. Emri dhe/ose kodi tarifor për kimikatin që prodhohet/importohet:
3. Emri i personit fizik/juridik që prodhon/importon:
4. Data e regjistrimit

MINISTRI

Emër mbiemër

(firma, vula)